



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS  
PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Mars 2021**

**Data 24.03.2021 ora 14.00**

**Vendi: Mbledhja zhvillohet :10 këshilltarë prezent në sallë, 11 këshilltarë online me aplikacion Meet, mbështetur në Aktin Normativ nr.3 datë 15.03.2020, neni 5, i**

**ndryshuar, urdherit Ministrisë Shëndetësisë nr.633 dt.17.11.2020 me këtë rend dite:**

1. Projekt Vendim ‘‘ mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2021’’

2. Projekt vendim për dhenien në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor ( Pyje që kullohen ) për kullotjen e bagetive të imëta.

3. Projekt vendim për miratimin e heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes 12.9 ha në ngastren nr.4 dhe ngastren nr.10 ekonomia pyjore Drin Gjader Kir.

4. Projekt propozim ‘‘Për dhënie ‘‘Çertifikatë Mirënjohje’’, Dr.Edison Shimaj, Z.Besmir Mataj. Mrizit të Zanave Agroturizëm’’

5. Projekt vendim për dhenie ndihme të menjehershme financiare familjeve të demtuara nga reshjet e periudhës 07.01.2021-11.01.2021 banorë të Bashkisë Vau Dejës.

6. Projekt vendim për dhenie ndihme të menjehershme financiare familjeve të demtuara nga reshjet e periudhës 07.01.2021-11.01.2021 banorë të Bashkisë Vau Dejës.

7. Projekt vendim për miratimin e tavaneve të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, faza e parë për Bashkinë Vau Dejës.

8. Projekt vendim për emërtimin e shkollës së Mesme Mjedë.

9. Të ndryshme.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Mars 2021, u zhvillua me datë 24.03.2021 ora 14.00 online sipas aplikacionit Meet me 10 këshilltarë prezent në sallë dhe 11 këshilltarë online me aplikacionin Meet. Të pranishëm online dhe në sallë ishin 21 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit. Fjalën për hapjen e mbledhjes e mori Z.Mark Bisha, kryetari i këshillit bashkiak.



Z.Mark Bisha lexoi rendin e ditës dhe u pyeten këshilltarët nëse ishin dakort për rendin e ditës.Këshilltarët nuk kishin për të propozuar ndonjë shtesë apo pakësim në rendin e ditës.

Z Mark Bisha e hedh në votim rendin e ditës.**MIRATOHET me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e parë e rendit të dites nga z.Mark Bisha: Projekt Vendim “ mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2021”**i cili relaton per këshilltarët se per kete pike te rendit te dites eshte mbledhur komisioni i sherbimeve sociale dhe ceshtjeve gjinore i cili ka propozuar qe ky projekt vendim te miratohet.

Fjalën e merr znj.Nazire Brahimi-pergjegjese e zyres se ndihmes ekonomike e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur.

Zoti Mark Bisha pyet nqs këshilltarët kanë diçka për të shtuar apo janë dakort me projekt vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka per te shtuar,hidhet ne votim:**Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e dytë e rendit të dites nga z.Mark Bisha: Projekt vendim per dhenien ne perdorim me kontrate qeraje te fondit pyjor ( Pyje qe kulloten ) per kullotjen e bagetive te imëta 2021”**i cili relaton për këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i Bujqësisë,Pyjeve,Menaxhimit të ujërave dhe mbrojtjes së mjedisit i cili ka propozuar që ky projekt vendim të miratohet. Z.Mark ju bëri me dije këshilltarëve se për këtë projekt vendim është bërë dëgjese publike dhe se të pranishmit në dëgjese kishin shprehur dakortësi për miratim të këtij projekt vendimi.

Fjalën e merr Z.Zeqir Ujka-përgjegjës i zyrës së administrimit të pyjeve dhe kullotave i cili relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur.

Zoti Mark Bisha pyet nqs këshilltarët kanë diçka për të shtuar dhe janë dakort me projekt vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka per te shtuar,hidhet ne votim:**Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e tretë e rendit të dites nga z.Mark Bisha: Projekt vendim per miratimin e heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes 12.9 ha ne ngastren nr.4 dhe ngastren nr.10 ekonomia**



**pyjore Drin Gjader Kir** i cili relaton per këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i Bujqësisë,Pyjeve, Menaxhimit të ujërave dhe mbrojtjes së mjedisit i cili ka propozuar që ky projekt vendim të miratohet. Fjalën e merr Z.Zeqir Ujka-përgjegjës i zyrës së administrimit të pyjeve dhe kullotave i cili relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Zoti Mark Bisha pyet nqs këshilltarët kanë diçka për të shtuar dhe janë dakort me projekt vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka per te shtuar, hidhet ne votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e katërt e rendit të dites nga z.Mark Bisha: Projekt propozim “Për dhënie “Çertifikatë Mirënjohje”, Dr.Edison Shimaj, Z.Besmir Mataj, Mrizit të Zanave**

**Agroturizëm”** i cili relaton per këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i vlerësimit të figurave të shquara dhe emërtesave i cili ka propozuar që ky projekt vendim të miratohet. Z.Mark Bisha sqaron që propozimi për vlerësimin e Dr.Edison Shimaj është bërë nga këshilli i bashkisë, ndërsa propozimi për vlerësimin e Z.Besmir Mataj dhe Mrizi i Zanave Agroturizëm është bërë nga Qendra e të Moshuarve “Besa” Barbullush. Z.Mark Bisha gjithashtu bëri një përshkrim të përgjithshëm për secilin nga emrat e propozuar për vlerësim si dhe aktivitetin dhe kontributin e tyre në ndihme të komunitetit.

Zoti Mark Bisha pyet nqs këshilltarët kanë diçka për të shtuar dhe janë dakort me projekt vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka per te shtuar, hidhet ne votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e pestë e rendit të dites nga z.Mark Bisha: Projekt vendim per dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjeve të demtuara nga reshjet e periudhës 07.01.2021-**

**11.01.2021 banorë të Bashkisë Vau Dejës. ”** i cili relaton per këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i rendit publik dhe mbrojtjes civile i cili ka propozuar që ky projekt vendim të miratohet. Fjalën e merr Znj. Valjeta Nikaj përgjegjëse e zyrës së mbrojtjes civile e cili relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur.

Zoti Mark Bisha pyet nqs këshilltarët kanë diçka për të shtuar dhe janë dakort me projekt



vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka për të shtuar, hidhet në votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e gjashtë e rendit të ditës nga z. Mark Bisha: . Projekt vendim për dhënie ndihme të menjehershme financiare familjeve të dëmtuara nga reshjet e periudhës 07.01.2021-11.01.2021 banorë të Bashkisë Vau Dejës.** i cili raporton për këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i rendit publik dhe mbrojtjes civile i cili ka propozuar që ky projekt vendim të miratohet. Fjalën e merr Znj. Valjeta Nikaj përgjegjëse e zyrës së mbrojtjes civile e cili raporton lidhur me projekt vendimin e paraqitur.

Zoti Mark Bisha pyet nëq këshilltarët kanë diçka për të shtuar apo janë dakort me projekt vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka për të shtuar, hidhet në votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e shtatë e rendit të ditës nga z. Mark Bisha: Projekt vendim për miratimin e tavaneve të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesem 2022-2024, faza e parë për Bashkinë Vau Dejës.** i cili raporton për këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i financave, buxhetit dhe aseteve publike i cili ka propozuar që ky projekt vendim të miratohet. Fjalën e merr Znj. Jolanda Mema përgjegjëse e zyrës financiare e cila raporton lidhur me projekt vendimin e paraqitur.

Zoti Mark Bisha pyet nëq këshilltarët kanë diçka për të shtuar apo janë dakort me projekt vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka për të shtuar, hidhet në votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e tetë e rendit të ditës nga z. Mark Bisha: Projekt vendim për emërtimin e shkollës së Mesme Mjedë”** i cili raporton për këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i vlerësimit të figurave të shquara dhe emërtesave i cili ka propozuar që ky projekt vendim të miratohet. Z. Mark sqaron që propozimi për emërtimin e shkollës së Mesme Mjedë



është bërë nga kryetari i bashkisë Z.Mark Babani që ti vendoset emri “Hasan Meti”. Z.Mark Bisha vazhdon me përshkrimin e biografisë së Z.Hasan Meti.

Zoti Mark Bisha pyet nëq këshilltarët kanë diçka për të shtuar apo janë dakort me projekt vendimin e paraqitur.

Këshilltarët nuk kishin diçka për të shtuar, hidhet në votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

**Lexohet pika e nëntë e rendit të dites nga z.Mark Bisha: Të ndryshme.**

- Z.Mark Bisha shtron si problem ndaj nënkryetares së bashkisë pedonale në Vau Dejës pasi është dëmtuar ndjeshëm nga traila me pesha të rëndë që kalojnë në të në mënyrë të vazhdueshme dhe kërkon që ti kushtohet më tepër vëmendje.
- Zonja Nënkryetare u përgjigj që do të merren masa për parandalimin e dëmtimit të pedonale duke vendosur tabela që ndalojnë mjetet me pesha të rënda të kalojnë nëpër pedonale, si dhe mirëmbajtjen e saj jo vetëm nga bashkia por edhe nga komuniteti pasi duhet të ndërgjegjësohen sidomos në hedhjen e mbeturinave.
- Një tjetër problem i paraqitur nga kryetari i këshillit është dhe policia bashkiake e cila qarkullon në grupe nëpër pedonale dhe nuk arrin të shmangë dëmtimet e vazhdueshme që i kanosen zonës qoftë nga vetë banorët apo dhe nga individ të tjerë.  
Z.Afrim Kapidanja këshilltar, pyet përse në fshatin Barbullush nuk ka filluar akoma procesi i rregullimit të sistemit të vaditjes dhe kullimit?
- Nënkryetrja i përgjigjet që dhe në fshatin Barbullush do të fillojnë së shpejti pasi do të punohet në të gjithë fshatrat e bashkisë.
- Një tjetër problem i paraqitur nga kryetari i këshillit është dhe ndriqimi pasi është dëmtuar dhe banorët kanë shprehur pakënaqësi për këtë problem.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilltarët nuk kishin diçka tjetër për të diskutuar.

Z.Mark Bisha- kryetar i keshillit mbyll mbledhjen e radhes se Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2021.

Mbajtesi Protokollit Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

Albin Koprdhaja  
Ervis Shimej  
Frang Bredha  
Imriq Isola  
Johel Gosa  
Mark Bisha